



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 02/2025 PËR PLOTËSIMIN
DHE NDRYSHIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (QRK) NR.
12/2022 PËR REGJISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ORGANIZATAVE
JOQEVERITARE¹**

¹ Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 02/2025 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 12/2022 për Regjistrimin dhe Funkcionimin e Organizatave Joqeveritare, është miratuar në mbledhjen e 249-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 03/249, të datës 26.02.2025.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 25, paragrafit 7, nenit 42, paragrafit 2 dhe nenit 46 të Ligjit Nr. 06/L- 043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare (Gazeta Zyrtare Nr. 11, 24 prill 2019) si dhe në pajtim me nenin 78, paragrafin 6, nënparagrafin 6.2 të Rregullores (QRK)- Nr. 17/2024 së Punës së Qeverisë të Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 02/2025 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (QRK) NR. 12/2022 PËR REGJISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ORGANIZATAVE JOQEVERTARE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është plotësimi dhe ndryshimi i Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 12/2022 për Regjistrimin dhe Funkcionimin e Organizatave Joqeveritare (më tutje referuar si “Udhëzimi bazë”).

Neni 2

Neni 1, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. i Udhëzimit bazë ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1.1. **Ligji** – nënkupton Ligjin Nr. 06/L-043 dhe Ligjin Nr. 08/L-244 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare.

Neni 3

Pas paragrafit 4, nënparagrafit 4.6 tek neni 7 i Udhëzimit bazë shtohet nënparagrafi i ri 4.7 me tekstin si në vijim:

4.7. angazhimin për kapital fillestar për themelimin e fondacionit, i cili duhet të jetë jo më pak se një mijë euro (1,000 €), me testament, apo me lënie të trashëgimisë.

Neni 4

1. Neni 9, paragrafi 2 i Udhëzimit bazë ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

2. Departamenti shqyrton kërkesën në afat prej dyzet e pesë (45) ditësh, nga data e pranimit të kërkesës.

2. Neni 9, paragrafi 9 i Udhëzimit bazë ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

9. Pala e interesuar për themelimin të OJQ-së, e cila nuk pajtohet me vendimin e Departamentit, ka të drejtë ankese në Komisionin për Ankesa si organ i shkallës së dytë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, në pajtim me ligjin përkatës mbi procedurën e përgjithshme administrative dhe rregulloren përkatëse për komisionin e ankesave.

Neni 5

Pas nenit 12 të Udhëzimit bazë, shtohet një nen i ri 12A me tekstin si në vijim:

Neni 12A Shqiptimi i gjobave

1. OJQ e cila nuk përmbush detyrimin sipas paragrafit 1 të nenit 29 të Ligjit gjobitet në shumë prej dyqind e pesëdhjetë euro (250 €), ndërsa përfaqësuesi i autorizuar gjobitet në shumë prej tetëdhjetë euro (80€).

2. Shqiptimi i gjobave bëhet nga Departamenti në pajtim me ligjin përkatës për kundërvajtje.

Neni 6

Neni 14, paragrafi 4 i Udhëzimit bazë ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

4. Brenda dyzet e pesë (45) ditësh, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës nga paragrafi 1 të këtij neni, nëse dokumentet e regjistrimit dëshmojnë se qëllimet dhe veprimtaria e OJQ-së i plotësojnë kërkesat e nenit 37 të Ligjit, Departamenti nxjerr vendim për lejimin apo refuzimin e statusit të përfitimit publik për OJQ-në kërkuese.

Neni 7

Neni 15, paragrafi 7 i Udhëzimit bazë ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

7. Brenda dyzet e pesë (45) ditësh, Departamenti shqyrton kërkesën e paraqitur të OJQ-së për rinjohjen e statusit për përfitim publik dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të plotësimit të kriterëve të përcaktuara në nenin 39 të Ligjit, nxjerr vendim për rinjohje apo refuzim të rinjohjes të statusit për përfitim publik

Neni 8

Neni 16, paragrafi 3 i Udhëzimit bazë ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

3. Departamenti shqyrton dhe merr vendim për kërkesën mbi tërheqjen e statusit për përfitim publik, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas pranimit të kërkesës për tërheqje të statusit për përfitim publik dhe i dërgon OJQ-së njoftimin me shkrim se statusi i saj për përfitim publik, së bashku me të gjitha përfitimet që rrjedhin nga statusi, janë ndërprerë.

Neni 9

Neni 18, paragrafi 4 i Udhëzimit bazë ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

4. OJQ-ja e cila nuk pajtohet me vendimin e Departamentit, për çështjet e çregjistrimit, ka të drejtë ankese në Komisionin për Ankesa si organ i shkallës së dytë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, në pajtim me ligjin përkatës mbi procedurën e përgjithshme administrative dhe rregulloren përkatëse për komisionin e ankesave.

Neni 10 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës
28 shkurt 2025